Numër:01/606
Datë: 01.11.2024

Në mbështetje të neneve 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare; nenit 5 paragrafit 8 dhe nenit 6 paragrafit 1 të Rregullores Nr.01/196 të punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve; nenit 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e jashtëzakonshme, të mbajtur online, me datë 31.10.2024, me votim unanim të gjithë pjesëmarrësve, mori këtë:

VENDIM

1. Shtyhet afati fillestar për shqyrtim dhe vendosje për ankesën e institucionit "Sellma Academy" protokoluar me Nr.01-583, datë 24.09.2024, kundër Vendimit të Autoritetit Kombëtart të Kualifikimeve Nr.02/562, i datës 10.09.2024.
2. Vendimi për ankesën e parashtruar do të merret jo më larg se dyzet e pesë ditë (45) shtesë nga nxjerrja e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do t'i komunikohet parashtrueses së ankesës, institucionit "Sellma Academy", në rrugë elekteronike dhe fizike.

Arsyetim

Institucioni "Sellma Academy", me datë 24.09.2024, ka parashtruar ankesë për Këshillin Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (KD i AKK), protokoluar me Nr.01/01-583, kundër Vendimit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me Nr.02/562, të datës 10.09.2024.

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (KD i AKK) për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative, rrethanave të brendshme të AKK-së, pamundësisë së mbajtjes së mbledhjes së rregullt të KD të AKK, ka konstatuar se i nevojitet kohë shtesë për shqyrtimin e ankesës.

Andaj KD i AKK, me vota unanime, ka vendosur të shtyhet afati fillestar për shqyrtimin dhe vendosjen mbi ankesën e institucionit "Sellma Academy", me qëllim të nxjerrjes së një vendimi meritor dhe të drejt.